



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 103

Datë 7 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 413, datë 25.6.2014	Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme, dhe trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve shoqërive tregtare, të objekteve shtetërore të veçuara, të privatizuara, të objekteve apo ndërtesave të shitura të ish-kooperativave bujqësore, si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit.....	3955
Vendim i KM nr. 414, datë 25.6.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Financave.....	3958
Vendim i KM nr. 415, datë 25.6.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar	3658
Vendim i KM nr. 417, datë 25.6.2014	Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit.....	3959
Vendim i KM nr. 418, datë 25.6.2014	Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim.....	3960
Vendim i KM nr. 420, datë 25.6.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 308, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë-Vorë, krahut i majtë”, të ndryshuar.....	3962
Vendim i KM nr. 422, datë 25.6.2014	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, në lidhje me rregulloren e punësimit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit.....	3963

Vendim i KM nr. 423, datë 25.6.2014	Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit.....	3968
Vendim i KZHR nr. 6, datë 10.6.2014	Për shpërndarjen e fondit për arsimin, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, si edhe për një ndryshim në vendimin nr. 5, datë 9.5.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpalljen e thirrjes për ndarjen e fondit për arsimin, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve”	3969

VENDIM
Nr. 413, datë 25.6.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË
PROCEDURAVE TË SHITJES SË TROJEVE NË
PËRDORIM, SIPËRFAQE TË DOMOSDOSHME,
DHE TROJEVE SHITESË FUNKSIONALE TË
NDËRMARRJEVE SHOQËRIVE TREGTARE, TË
OBJEKTEVE SHTETËRORE TË VEÇUARA, TË
PRIVATIZUARA, TË OBJEKTEVE APO
NDËRTESAVE TË SHITURA TË ISH-
KOOPERATIVAVE BUJQËSORE, SI DHE TË
NDËRTESAVE TË NDËRTUARA NË BAZË TË
LEJEVE TË NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", të ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij", si dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.9.1995, "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT E SHITJES SË TRUALLIT NË PËRDORIM, SIPËRFAQE TË DOMOSDOSHME, TË NDËRMARRJEVE DHE OBJEKTEVE SHTETËRORE, TË VEÇUARA, TË PRIVATIZUARA, TË OBJEKTEVE APO NDËRTESAVE TË SHITURA TË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE, SI DHE TË NDËRTESAVE TË NDËRTUARA NË BAZË TË LEJEVE TË NDËRTIMIT

1. Me "truall, sipërfaqe e domosdoshme" nënkuptohen sipërfaqet e truallit të përcaktuara në genplanin dhe dokumentacionin në momentin e privatizimit të ndërmarrjeve apo objekteve, ku përfshihet sipërfaqja nën objekt dhe sipërfaqja funksionale, nëse ka, si dhe sipërfaqet e truallit sipas genplanit dhe dokumentacionit të dhënies së lejes së ndërtimit, në të cilat janë përcaktuar sipërfaqja e objektit apo e sheshit të ndërtimit.

2. Shitja e truallit të pashitur, sipërfaqe e domosdoshme të ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore, të privatizuara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, degët e saj në rrethe, nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, me degët e saj në rrethe, të bëhet, në përputhje me këtë vendim, nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, sipas genplanit dhe dokumentacionit në momentin e

privatizimit të tyre. Kjo drejtori kryen edhe shitjen e trojeve të ndërmarrjeve e objekteve të tjera shtetërore, të privatizuara para krijimit të këtyre agjencive, si dhe të truallit të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, sipas genplaneve dhe dokumentacionit në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit, në të cilin janë përcaktuar objekti apo sheshi i ndërtimit, si dhe trojet e objekteve apo ndërtesave të shitura, ish-pronë e ish-kooperativave bujqësore.

3. Personi fizik apo juridik privat, i cili do të blejë truallin e ndërmarrjes ose të objekteve që janë privatizuar më parë apo ndërtuar sipas lejeve të ndërtimit, si dhe trojet e objekteve apo ndërtesave, ish-pronë e ish-kooperativave bujqësore, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, duhet të paraqesë në dy kopje, në Ministrinë e Financave, për Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën, me shkrim, për blerje të truallit;

b) Vërtetimin hipotekor apo kartelën e pasurisë, për objektin apo objektet që ka në pronësi, të lëshuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, së bashku me hartën treguese të pasurive të paluajtshme, të përditësuar, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës;

c) Kopjen e noterizuar të kontratës së shitjes së objektit apo të ndërmarrjes, lëshuar nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore dhe nga ndërmarrjet përkatëse, përpara krijimit të agjencive, si dhe fotokopjen e noterizuar të genplanit ose të planimetrisë së objektit apo të ndërmarrjes (në çastin e privatizimit);

ç) Kopjen e noterizuar të lejes së ndërtimit, genplanin e miratuar sipas lejes së ndërtimit, për rastet e objekteve të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim;

d) Kopjen e noterizuar të kontratës së blerjes, bashkë me genplanin përkatës për objektet apo ndërtesat, ish-pronë e ish-kooperativave bujqësore;

dh) Deklaratën noteriale në 2 (dy) kopje origjinale, që vërteton se nuk ka konflikt me të tretët;

e) Vërtetim nga organet e pushtetit vendor për pagesën e qirasë së truallit në përdorim nga data e lidhjes së kontratës së shitjes apo dhënies së lejes së ndërtimit deri më datën 7.6.2010;

ë) Vërtetim nga zyrat rajonale tatimore për pagesën e taksës së përdorimit të truallit nga data 7.6.2010 deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për blerjen e truallit.

4. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kërkon pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrës përkatëse vendore të regjistrimit të pasurive të

paluajtshme konfirmim për statusin e truallit, çmimin përkatës të shitjes, të përcaktuar në hartën e vlerës, dhe hartën treguese, me të dhënat e nevojshme gjeografike për zonën përkatëse, brenda afateve të mëposhtme:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij vendimi, për rastet kur privatizimet janë kryer nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe, nëse dosja e privatizimit gjendet e rregullt, si dhe nëse dokumentacioni i dorëzuar nga ana e kërkuesit është në përputhje me pikën 3 të kreut I të këtij vendimi.

b) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbërritjes, përkatësisht, të dokumentacionit të privatizimit, nga drejtoritë rajonale të Bujqësisë, për privatizimet e kryera nga ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, të dokumentacionit të dhënies së lejes së ndërtimit nga organet e pushtetit vendor dhe të dokumentacionit të objekteve apo ndërtesave të ish-kooperativave bujqësore.

5. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i kthen përgjigje Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Ndërsa, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, i përcjellin kësaj drejtorie hartën treguese përkatëse, me të dhënat e nevojshme gjeografike dhe statusin e truallit që kërkohet të privatizohet.

6. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryen shitjen e truallit dhe lidhjen e kontratës vetëm në rastet kur trualli ka pronar shtetin, pavarësisht nëse për truallin në fjalë ka vendim për njohje nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve apo Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

7. Organet e qeverisjes vendore apo çdo organ tjetër shtetëror në territorin e të cilit ndodhet objekti, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, i përcjellin kësaj drejtorie, përkatësisht, vërtetimin që subjekti kërkues ka paguar qiranë e truallit nga data e lidhjes së kontratës së shitjes së objektit deri në datën 7.6.2010, si dhe koeficientin e bashkëpronësisë për objektet me dy a më shumë kate. Drejtoritë rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, duhet të konfirmojnë pagesën për taksën e përdorimit të truallit nga data 7.6.2010 deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për blerjen e truallit.

8. Vlera e qirasë së tokës, e arkëtuar pranë organeve të qeverisjes vendore apo organeve të tjera shtetërore me të cilat subjektet kanë lidhur kontratë qiraje, ndahet, si më poshtë vijon:

- 70 % për buxhetin e shtetit;

- 30 % për organin e qeverisjes vendore apo organin shtetëror përkatës.

9. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm nga organet e qeverisjes vendore, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe arkivat shtetërore vendore, njofton kërkuesin për t'u paraqitur pranë këtij institucioni, ku do të marrë informacion për vlerën e truallit që ai kërkon të privatizojë, si dhe për marrjen e autorizimit për pagesën e vlerës së truallit. Pagesa kryhet vetëm me lekë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit.

Të ardhurat e mbledhura nga procesi i privatizimit apo i shitjes së truallit shtetëror kalojnë 75 për qind në buxhetin e shtetit dhe 25 për qind në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore.

10. Kur objekti është me dy a më shumë kate dhe në të ka disa pronarë, atëherë shitja e truallit të bëhet në bashkëpronësi, sipas pjesëve takuese.

11. Në rastet kur në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, mungon dosja e privatizimit të objektit, genplani, akti i dorëzimit apo dokumente të tjera të momentit të privatizimit, për arsye objektive, kopja e dosjes së vlerësimit e konfirmuar (privatizimit apo dokumentacionit që i mungon dosjes) të objektit ose ndërmarrjes do të kërkohet në degët e shoqërive publike, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në juridiksionin e të cilave ndodhet objekti, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave ose Arkivin Shtetëror Vendor, arkivat noterialë, apo çdo institucion tjetër ku janë të depozituara dokumentacionet përkatëse për këto objekte. Po kështu, do të veprohet edhe për dokumentacionin e dhënies së lejes së ndërtimit, genplanit të miratuar sipas lejes së ndërtimit, për rastet e ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, si dhe të objekteve apo ndërtesave, ish-pronë e ish-kooperativave bujqësore.

12. Për rastet kur mungon vetëm genplani për objektet, sipas përcaktimit në pikën 2 të kreut I të këtij vendimi, atëherë, mbi bazën e dosjes së privatizimit apo të lejes së ndërtimit, subjektit që ka në pronësi objektin, i kërkohet plotësimi me genplan, të hartuar nga një ekspert i licencuar, i sipërfaqes së truallit sipas dosjes përkatëse të privatizimit apo ndërtimit.

13. Ky vendim nuk zbatohet për procedurat e vlerësimit të truallit të objekteve apo ndërmarrjeve, dokumentacioni i të cilave ndodhet në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave.

II. PROCEDURAT PËR SHITJEN E TROJEVE SHITESË FUNKSIONALE, TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE APO TË OBJEKTEVE TË VEÇUARA SHTETËRORE, TË PRIVATIZUARA, DHE TË NDËRTESAVE TË NDËRTUARA MBI BAZËN E LEJEVE TË NDËRTIMIT, TË LËSHUARA NGA ORGANET E QEVERISJES VENDORE PAS DATËS 10.8.1991 E NË VAZHDIM

1. Me “truall shtesë funksional” për ndërmarrjet, objektet e veçuara të privatizuara dhe ndërtesat e ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, sipas këtij vendimi, nënkuptohet truallit që kërkohet nga pronarët e ndërmarrjeve, të objekteve të privatizuara prej tyre dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, për zgjerim, shërbime apo ristrukturim të veprimtarisë dhe që, në bazë të rregullave urbanistike, janë të konfirmuara nga zyrat e urbanistikës në prefekturën e qarkut përkatës.

2. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryen procedurën e shitjes së trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve shtetërore, të objekteve të veçuara të privatizuara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Agjencia Qendrore e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, ish-Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, të cilat kanë në pronësi sipërfaqen e truallit, sipërfaqe e domosdoshme.

3. Kërkesa për kryerjen e procedurave të shitjes së trojeve shtesë funksionale në favor të subjekteve që kanë privatizuar ndërmarrje, objekte të veçuara apo ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, të përcaktuar në këtë vendim, paraqitet nga kërkuesit pranë Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, sipas përcaktimit në pikën 3 të kreut I të këtij vendimi, së bashku me kopjen e noterizuar të kontratës së blerjes së truallit sipërfaqe e domosdoshme dhe genplanin e sipërfaqes së kërkuar për t'u blerë, të përgatitur nga ekspertë të licencuar.

4. Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, nëse konstaton se dokumentacioni i depozituar është në përputhje me pikën 3 të kreut II të këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbërritjes së kërkesës, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme konfirmim për

çmimin përkatës të shitjes, të përcaktuar në hartën e vlerës, dhe statusin e truallit në zonën përkatëse.

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes në dorëzim të kërkesës nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryejnë verifikimin e hollësishëm të këtij dokumentacioni, për të vërtetuar se truallit që kërkohet të shitet nuk është i kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe është në pronësi të shtetit, si dhe konfirmon çmimin e përlllogaritur të sipërfaqes së truallit që do të shitet, sipas hartës së vlerës. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme konfirmon statusin juridik të truallit dhe hartën treguese me të dhënat e nevojshme gjeografike.

5. Dokumentacioni dhe sipërfaqet e truallit shtesë funksional për ndërmarrjet, objektet e veçuara shtetërore të privatizuara dhe ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore pas datës 10.8.1991 e në vazhdim, verifikohen dhe konfirmohen nga një komision, i cili ka në përbërje përfaqësues nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, nga prefektura e qarkut përkatës (punonjësi i zyrës së urbanistikës) dhe nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sipërfaqja e truallit shtesë që përfitohet nga subjektet kërkuese duhet të jetë në përputhje me masën e përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në këtë komision, nga ana e përfaqësuesve të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe përfaqësuesit të prefektit të qarkut duhet të konfirmohet dhe të garantohet se truallit shtesë funksional që kërkohet të privatizohet është pasuri shtetërore dhe i patransferuar në inventarin e njësive të qeverisjes vendore, në bazë të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

6. Komisioni i ngritur sipas pikës 5 të kreut II të këtij vendimi, pas verifikimit të dokumentacionit dhe të sipërfaqes së truallit shtesë funksional, të kërkuar, mban procesverbal për çdo rast dhe nënshkruan genplanin që i përket sipërfaqes së truallit shtesë.

7. Shitja e truallit shtesë funksional kryhet vetëm me lekë dhe të ardhurat e realizuara nga kjo shitje kalojnë 100 % në buxhetin e shtetit.

8. Kalimi i pronësisë së sipërfaqes së truallit shtesë funksional bëhet nëpërmjet kontratës së shitjes, e cila nënshkruhet nga drejtori i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, dhe blerësi, pas kryerjes së pagesës së plotë të vlerës së truallit, të përcaktuar në autorizimin për kalimin e pronësisë.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 738, datë 8.9.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të

procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme dhe shtesë funksionale të ndërmarrjeve shoqërive apo të objekteve shtetërore, të veçuara të privatizuara, dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SASIA E SIPËRFAQES SHITESË QË MUND TË PËRFTOJNË SUBJEKTET PËR OBJEKTE TË VEÇUARA TË PRIVATIZUARA DHE PËR NDËRTESAT E NDËRTUARA MBI BAZËN E LEJEVE TË NDËRTIMIT

Sipërfaqja e objekteve të privatizuara (nën objekt + funksionale)	Shtesa e sipërfaqeve
Sipërfaqet 1 m ² deri në 50 m ²	Deri në 150 m ²
Sipërfaqet nga 51 m ² deri në 100 m ²	Deri në 200 m ²
Sipërfaqet nga 101 m ² -500 m ²	Deri në 400 m ²
Sipërfaqet nga 501 m ² -1000 m ²	Deri në 600 m ²
Sipërfaqet nga 1001 m ² -5000 m ²	Deri në 2500 m ²
Sipërfaqet mbi 5000 m ²	Deri në 5000 m ²

VENDIM
Nr. 414, datë 25.6.2014

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, në zërin “Shpenzime kapitale”, t’i shtohet fondi 198 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 415, datë 25.6.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2014 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

a) “1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014 në njësitë e qeverisjes qendrore është 865 veta, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.

b) Pas lidhjes nr. 4 shtohet lidhja nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila detajon ndarjen e shtesës prej 100 (njëqind) punonjësish, të miratuar me këtë vendim.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondet buxhetore dhe nga të ardhurat e siguruara nga ALUIZNI, për vitin 2014.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të depozitojë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, me emërtesën “specialist” dhe “teknik i specialiteteve të ndryshme”, brenda numrit të përcaktuar për çdo drejtori të ALUIZNI-t dhe brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen

e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 5

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periodhë kohore
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Strehimit	100	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Tirana 1	24	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Tirana 2	10	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Tirana 3	29	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Durrës	10	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Elbasan	6	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Korçë	2	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Shkodër	5	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Lezhë	2	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Vlorë	3	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Fier	5	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Kukës	1	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Dibër	1	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Gjirokastrë	1	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Drejtorja e ALUIZNI-t Berat	1	Specialist/teknik i mesëm	8 orë/ditë	01.07.2014-30.11.2014
	Total punonjës me kontratë	100			

VENDIM
Nr. 417, datë 25.6.2014

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË LEJEVE
TË MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e vlerave përkatëse të tarifave për:
 - kërkesën për leje mjedisi të tipave A, B ose C;
 - kërkesën për një ndryshim të kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A ose të tipit B;
 - tarifën vjetore për instalimet e tipave A, B dhe C.
- Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me atë që u jepet përkatësisht në:
 - ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
 - ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
 - ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- Tarifa përkatëse e shërbimit për shqyrtimin e kërkesës është, si më poshtë vijon:

a) Për leje mjedisi të tipit A, 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

b) Për leje mjedisi të tipit B, 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

c) Për leje mjedisi të tipit C, 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

ç) Për ndryshim të kushteve të lejes së mjedisit të tipit A, 20 000 (njëzet mijë) lekë;

d) Për ndryshim të kushteve të lejes së mjedisit të tipit B, 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

4. Operatorët paguajnë në llogari të ministrisë tarifën vjetore për:

a) instalimet e tipit A, në shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh;

b) instalimet e tipit B, në shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

5. Operatorët e instalimeve të tipit C paguajnë një tarifë vjetore prej 2 000 (dy mijë) lekësh në llogarinë bankare të ARM-së së qarkut përkatës.

6. Tarifa vjetore paguhet brenda 3-mujorit të parë të vitit dhe një kopje e mandatpagesës dorëzohet pranë ARM-së së qarkut ku ndodhet instalimi.

7. Tarifa derdhet nga kërkuesi në llogarinë bankare të Ministrisë së Mjedisit dhe është e pakthyeshme. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në këtë vendim derdhen në buxhetin e shtetit.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, udhëzimi nr. 5, datë 28.12.2007, i ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, "Për tarifat e shërbimit për leje mjedisore", shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe Qendra Kombëtare e Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 418, datë 25.6.2014

**PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË
MBETJEVE NË BURIM¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i afateve dhe masave për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:

- a) optimizimit të grumbullimit të mbetjeve;
- b) sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim;
- c) promovimit të ripërdorimit të produkteve;
- ç) përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit;
- d) përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

II. OBJEKTI

Objekt i këtij vendimi është realizimi i grumbullimit të diferencuar për këto rryma mbetjesh:

- a) Letër/karton;
- b) Metal;
- c) Plastikë;
- ç) Qelq.

III. PËRKUFIZIME

Termat e përkufizuar në nenin 3 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

¹ Ky vendim transponon kërkesat e nenit 11 të direktivës kuadër të mbetjeve 2008/98/EC "Mbi mbetjet".

Numri CELEX 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22.11.2008, faqe 3-30.

a) "Mbetje të riciklueshme të thata", një grup mbetjesh ku përfshihen rrymat e mbetjeve: letër/karton, metal, plastikë, qelq, materialet e të cilave, nëpërmjet çdo operacioni rikuperimi, ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca për t'u përdorur si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera.

b) "Mbetje të pariciklueshme", një grup mbetjesh të parrezikshme të cilat nuk mund të rikuperohen, të ripërdoren dhe të ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca për t'u përdorur si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera.

c) "Mbetje të riciklueshme të njoma", një grup mbetjesh, ku përfshihen rrymat e mbetjeve të frutave dhe perimeve të pagatuara, mbetjet e biodegradueshme të gjeneruara nga kopshtet, si bar ose kërcëj lulësh, bimë dhe degë pemësh, mbetjet nga krasitjet etj.

ç) "Njësi e qeverisjes vendore" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

d) "Optimizim", gjetja e alternativave me koston më efektive dhe performancën më të lartë në grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

**IV. AFATET DHE MASAT E PËRGJITHSHME
PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË
RRYMAVE TË MBETJEVE**

1. Bashkitë e kategorisë së parë, në përputhje me përcaktimin e nenit 3 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, përcaktojnë, brenda datës 31 dhjetor 2016, masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të paktën për rrymat e mbetjeve të mëposhtme:

- a) Letër/karton;
- b) Metal;
- c) Plastikë;
- ç) Qelq.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 1 të kësaj ndarjeje, marrin, brenda 31 dhjetorit 2018, masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, të paktën për rrymat e mbetjeve të përcaktuara në pikën 1 të kësaj ndarjeje.

3. Masat e referuara në pikat 1 dhe 2 duhet të merren në përmbushje të kërkesave minimale të përcaktuara në aneksin I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 31 dhjetor 2020, duhet që, për përgatitjen, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta, ku përfshihen letra, metali, plastika dhe qelqi, të arrijnë objektivin, minimumi në 50% të peshës së përgjithshme të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2014.

5. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, duke u siguruar qytetarëve minimalisht një sistem grumbullimi mbetjesh prej tri grupesh për:

- a) mbetje të riciklueshme të thata;
- b) mbetje të riciklueshme të njoma;
- c) mbetje të pariciklueshme.

V. OBJEKTIVAT PËR RIPËRDORIMIN DHE RICIKLIMIN E RRYMAVE TË MBETJEVE

1. Objektivat specifikë, që duhet të arrihen nga njësitë e qeverisjes vendore për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve sipas peshës, duhet të jenë, si më poshtë vijon:

- a) Letër/karton (60%);
- b) Metal (50%);
- c) Plastikë (22.5%);
- ç) Qelq (60%).

2. Objektivat e ndërmjetëm duhet të parashikohen nga njësitë e qeverisjes vendore në planet e tyre të menaxhimit në përputhje me nevojat lokale dhe mundësitë aktuale. Objektivat e përcaktuar në pikën 1 janë të detyrueshëm për t'u arritur nga njësitë e qeverisjes vendore të çdo niveli.

3. Në planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të hartohen në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duhet të parashikohen masa e metoda për arritjen e objektivave brenda afateve të vendosura.

VI. BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE

Me qëllim arritjen e objektivave të parashikuar në pikën 1 të ndarjes V, njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në një prej instalimeve më të afërta, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.

VII. TARIFA E MBETJEVE

Tarifat, që duhen paguar nga prodhuesit e mbetjeve, përcaktohen nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 3 të nenit 16 të ligjit nr. 8652/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor". Tarifa duhet të mbulojë kostot e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në pikën e fundit të depozitimit.

VIII. RAPORTIMI PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

1. Çdo njësi e qeverisjes vendore i raporton në mënyrë periodike, brenda datës 31 janar të çdo viti, të dhënat për grumbullimin e rrymave të mbetjeve dhe objektivat në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit i përpunon të dhënat në nivel kombëtar për sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar dhe objektivat e arritur, i regjistron ato në regjistrin e krijuar për këtë

qëllim, i pasqyron në raportin e gjendjes së mjedisit dhe ia raporton ministrisë brenda datës 28 shkurt të çdo viti.

3. Ministria, mbështetur në të dhënat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, harton raportin për zbatimin e këtij vendimi, si pjesë integrale të raportit për zbatimin e ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, të parashikuar në pikën 1 të nenit 66, brenda 30 tetorit 2017, dhe më pas çdo tre vjet.

4. Format, që do të përdoret për përcaktimin e kërkesave për llogaritjen e objektivave dhe hartimin e raportit, të parashikuar në pikën 3, së bashku me informacionin që duhet përfshirë në të, përcaktohen me urdhrë të ministrit. Raporti referuar pikës 3 duhet të plotësojë kërkesat minimale të përcaktuara në aneksin II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera përkatëse duhet t'i sigurojnë ministrisë çdo informacion tjetër për përgatitjen e raportit të parashikuar në pikën 3.

6. Raporti referuar në pikën 3 publikohet në faqen elektronike zyrtare të ministrisë dhe bëhet i disponueshëm për publikun.

IX. AUTORITETET KOMPETENTE PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për marrjen e masave për arritjen e objektivave sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të parashikuara në këtë vendim.

3. Ministria është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

X. SANKSIONET

Shkeljet e dispozitave të këtij vendimi, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas nenit 62 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

ANEKSI I

KËRKESAT MINIMALE PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË MBETJEVE

(Referuar paragrafit 6 të seksionit IV të këtij vendimi)

1. Përcaktimi i kufijve administrativë të zonave të shërbimit të mbetjeve dhe të zonave përgjegjëse, duke përcaktuar qartë kush është përgjegjës për dispozitat e shërbimit të mbetjeve;

2. Përcaktimi i zonave kufi midis njësive lokale, kur

lindin pasiguri dhe konflikte për shkak të disa njësive të qeverisjes vendore, të cilat nuk ofrojnë ndonjë shërbim për menaxhimin e mbetjeve;

3. Informacion mbi prodhuesit e mbetjeve duke siguruar të dhëna të vlefshme se cila njësi e qeverisjes vendore do t'i grumbullojë ato;

4. Vlerësimi i volumit dhe specifikimit të llojit të mbetjeve që do të menaxhohen (informacioni përfshin të dhënat aktuale dhe të dhënat e mëparshme – për një periudhë 5 - 8 vjet në lidhje me popullsinë brenda zonës së tyre të përgjegjësisë, karakteristikat e tyre, numrin dhe përbërjen numerike mesatare të familjeve, llojin dhe kategorizimin e njësive të biznesit; industritë dhe institucionet, numrin e ndërtesave të bashkisë, edukimin, ndërtesat sociale ose të kulturës; njësitë shëndetësore brenda zonës së informacionit);

5. Informacioni shtesë mbi zhvillimin e mëtejshëm të të dhënave mbi familjet dhe bizneset në qytet duke specifikuar llojin e qëndrimit (banorë të përhershëm ose banorë të përkohshëm), si dhe banorët që jetojnë ilegalisht në zonat pranë kufijve të qytetit;

6. Përcaktimi i skemës së grumbullimit të mbetjeve dhe transportit të mbetjeve; kjo shpesh mund të përfshijë ose të shoqërojë aktivitete të tjera, të tilla si: ndarjen e mbetjeve, përpunimin, transferimin, etj.

Analiza dhe vlerësimi i situatës aktuale dhe/ose vendimi për përmirësimin e skemës ekzistuese ose të planit për të filluar një shërbim të ri duhet të përfshijë:

a) Pikat e grumbullimit të mbetjeve do të përmbajnë një ose më shumë kontenierë (zakonisht sistemin me tre kosha);

b) Frekuencën e grumbullimit të mbetjeve;

c) Kamionët dhe kontenierët e mbetjeve;

d) Përmirësimi i rrugëve të kamionëve.

Përzgjedhja e llojit të përshtatshëm të kontenierit në përputhje me sistemin e mbetjeve minimalisht prej tre koshash të përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi.

ANEKSI II

KËRKESAT MINIMALE PËR RAPORTIMIN

(Referuar paragrafit 14 të seksionit VIII të këtij vendimi)

Në nivel kombëtar:

1. Përshkrimi i metodave të grumbullimit të mbetjeve;

2. Përshkrimi i metodave të regjistrimit të sasive të rrymave të mbetjeve;

3. Të dhënat e mbledhura dhe informacioni siç është përshkruar në pikën 5 deri në 10 të këtij aneksi;

4. Vlerësimi i përgjithshëm mbi objektivat e arritur të rrymave të mbetjeve.

Në nivelin e qeverisjes vendore:

1. Të dhënat për mbetjet e gjeneruara sipas çdo rryme në periudhën e raportimit;

2. Pesha e përgjithshme për çdo rrymë mbetjeje të grumbulluar në mënyrë të diferencuar;

3. Pesha e përgjithshme për çdo rrymë mbetjeje nga lloji i materialeve përbërëse;

4. Lloji i mbetjeve të grumbulluara;

5. Si janë grumbulluar mbetjet;

6. Kush i ka grumbulluar mbetjet;

7. Sa shpesh janë grumbulluar mbetjet;

8. Identifikimi i kontraktorëve të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve;

9. Destinacioni i mbetjeve;

10. Sasia e mbetjeve të trajtuara/përpunuara dhe lidhja/marrëdhënia me sasinë e grumbulluar.

VENDIM

Nr. 420, datë 25.6.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 308, DATË 5.5.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS PARALELE TIRANË-VORË, KRAHU I MAJTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 308, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në listën bashkëlidhur vendimit hiqen pasuritë sipas lidhjes 1 dhe shtohen pasuritë sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 32 436 137 (tridhjetë e dy milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Nr. rendor	Pronari			Z. kadastrale	Nr.i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera(lekë)	Vlefë totale (lekë)
	Emër	Atësi	Mbiemër							
1	Kujtim		Nozllaku	2679	286/7	Objekt			0	3.545.838
2	Feti		Nozllaku	2679	286/6	Objekt			0	3.390.059
3	Bajram		Nozllaku	2679	81/2	Objekt			0	3.152.591
4	Luigj		Aliaj	2679	286/2	Objekt			0	27.159.270
5	Enver		Çausi	2679	1/24	Truall	693	2517	1.744.281	1.744.281
6	Ferdinant		Gjata	2679	80/17	Truall	480	2517	1.208.160	1.208.160
7	Kujtim		Nozllaku	2679	286/7	Truall	252	2517	634.284	634.284
8	Feti		Nozllaku	2679	286/6	Truall	252	2517	634.284	634.284
9	Bajram		Nozllaku	2679	81/2	Arë	410	365	149.650	149.650
10	Luigj		Aliaj	2679	286/2	Truall	2500	2517	6.292.500	6.292.500
Totali							4587		10.663.159	47.910.917

Lista e Pronave qe Shpronësohen nga ndertimi i segmentit rrugor
"Ndertim rrugët paralele superstrada Tirane Vore (krahu I majte)"

Lidhja nr.2

Nr.Rendor	PRONARI			Z.Kadastrale	Nr.Pasurise	Lloji i pasurise	siperfaqja totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lek/m2)	Vlera(Leke)	VLERA TOTALE (Leke)	SHENIME
	Emer	Atesi	Mbiemer									
1	"ALB-STAR" SH.P.K			2679	1/25	Are	3900	531	448	237.888	237.888	Bllokim Hipotekor ne favor te INTESA SANPAOLO BANK
2	Fuat	Shaban	Murati	2679	1/96	Are	4550	684	448	306.432	306.432	Konfirmohet nga ZVRPP
3	Fatos	Shygyri	Fucia	2679	1/11/32	Are	2000	70	448	31.360	31.360	Konfirmohet nga ZVRPP
4	Shygyri	Ramazan	Fucia	2679	1/79	Are	3140	392	448	175.616	175.616	Konfirmohet nga ZVRPP
5	Kujtim	Rushit	Fucia	2679	1/91	Are	820	198	448	88.704	88.704	Konfirmohet nga ZVRPP
6	I Paidentifikuar			2679	1/...	Are	--	4	448	1.792	1.792	I Pakonfirmuar
7	Kujtim	Rushit	Fucia	2679	1/84	Are	322	30	448	13.440	13.440	Konfirmohet nga ZVRPP
8	Kujtim	Rushit	Fucia	2679	1/85	Are	1053	158	448	70.784	70.784	Konfirmohet nga ZVRPP
9	Gani	Reshit	Fucia	2679	1/19	Are	1800	193	448	86.464	86.464	Konfirmohet nga ZVRPP
10	Reshit	Osman	Fucia	2679	1/56	Are	3070	269	448	120.512	120.512	Konfirmohet nga ZVRPP
11	Adil	Qamil	Gjini	2679	1/55	Are	800	42	448	18.816	18.816	Konfirmohet nga ZVRPP
12	Beqir	Reshit	Fucia	2679	1/59	Are	340	208	448	93.184	93.184	Konfirmohet nga ZVRPP
13	Ramazan	Maksut	Peza	2679	1/11/34	Are	2500	342	448	153.216	153.216	Konfirmohet nga ZVRPP
14	Islam	Maksut	Peza	2679	1/11/33	Are	2500	485	448	217.280	217.280	Konfirmohet nga ZVRPP
15	Ylli	Besim	Lleshi	2679	1/97	Are	1943	1559	448	698.432	698.432	Konfirmohet nga ZVRPP
Totali								5165		2.313.920	2.313.920	

VENDIM
Nr. 422, datë 25.6.2014

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË SHTETIT TË KATARIT, NË LIDHJE ME
RREGULLOREN E PUNËSIMIT TË
QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË SHTETIN E KATARIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare",

me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, në lidhje me rregulloren e punësimit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT NË LIDHJE ME RREGULLOREN E PUNËSIMIT TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETIN E KATARIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Katarit,
me dëshirën për forcimin e lidhjeve të miqësisë midis tyre;

duke kërkuar që të rregullojnë punësimin e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit do të ndërmarrin të gjitha procedurat e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Rekrutimi i fuqisë punëtore nga Republika e Shqipërisë, hyrja dhe punësimi në Shtetin e Katarit rregullohen në përputhje me ligjet dhe procedurat përkatëse që zbatohen në të dy vendet.

Neni 3

1. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit paraqet në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë kërkesat për rekrutim të punëdhënësve të Shtetit të Katarit për punësimin e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë merr masa për përmbushjen e kërkesave të tilla brenda mundësive dhe burimeve që ka në dispozicion.

2. Nëse një punëdhënës në Shtetin e Katarit dëshiron të rekrutojë dhe të punësojë qytetarë të Republikës së Shqipërisë me kualifikime të veçanta, punëdhënësi përcakton kualifikimet e tilla në kërkesën e tij, drejtuar Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit.

3. Punëdhënësi i Shtetit të Katarit ndjek dhe plotëson të gjitha procedurat e nevojshme, që kërkohen për zgjedhjen e punëtorëve dhe udhëtimin e tyre nga Republika e Shqipërisë në Shtetin e Katarit, qoftë vetë ose duke autorizuar një përfaqësues nga personeli i tij, ose nëpërmjet një zyre rekrutimi të autorizuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit.

Neni 4

Kërkesat e rekrutimit përshkruajnë kualifikimet e kërkuara, përvojën dhe specializimin, kohëzgjatjen e mundshme të kontratës, kushtet e detajuara të punës, veçanërisht pagat, shpërblimin në fund të shërbimit, periudhën e provës dhe lehtësirat në lidhje me transportin dhe strehimin, si dhe të gjitha të dhënat bazë që mund t'i japin mundësinë punëtorëve të vendosin për nënshkrimin e kontratës së punës.

Neni 5

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë duhet të marrë masat e nevojshme për punëtorët që do të punësohen në Shtetin e Katarit duke u siguruar punëtorëve informacion për kushtet e punës, shpenzimet dhe standardet e jetesës në Katar.

Neni 6

Qeveria e Shtetit të Katarit ndërmerr procedura për rikthimin e punëtorëve të Republikës së Shqipërisë kur përfundojnë kontratat e punësimit. Ajo gjithashtu mund të ndërmarrë të njëjtat procedura para përfundimit të kohëzgjatjes së kontratave, kur nuk ka më nevoja për punësim, me kusht që në rastin e dytë pagat e punëtorëve dhe të drejtat e tjera që u takojnë atyre t'u paguhen apo të përmbushen në bazë të kontratave të tyre të punësimit të lidhura me ta, ose në bazë të ligjit të punës të Shtetit të Katarit.

Neni 7

Qeveria e Shtetit të Katarit mund të ndërmarrë procedura për rikthimin e punëtorëve të Republikës së Shqipërisë, nëse prania e tyre në Shtetin e Katarit bie në kundërshtim me interesin publik ose sigurinë kombëtare të shtetit.

Kjo do të zbatohet pa cenuar të drejtat që u përkasin punëtorëve në bazë të kontratave të punësimit ose ligjit të punës të shtetit të Katarit.

Neni 8

a) Punëdhënësi përballon të gjitha shpenzimet e udhëtimit të punëtorëve nga Republika e Shqipërisë deri në vendin e punës në Shtetin e Katarit, kur ata fillojnë punën, si dhe përballon shpenzimet e kthimit të tyre nga Shteti i Katarit me mbarimin e punësimit të tyre. Punëdhënësi gjithashtu mbulon dhe shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje të punëtorëve gjatë periudha të pushimeve. Shpenzimet e tilla nuk mbulojnë koston e lehtësimit të pasaportës dhe as pagesën e ndonjë depozite.

b) Punëdhënësi përjashtohet nga shpenzimet për punëtorin që kthehet në shtëpi në dy rastet e mëposhtme:

1. Nëse punonjësi jep dorëheqjen para përfundimit të kontratës së punësimit, përveç rasteve të përfundimit të kontratës që specifikohen në nenin 51 të Ligjit të Punës të Shtetit të Katarit.

2. Nëse ai bën një gabim që kërkon shkarkimin e tij nga puna pa paralajmërim dhe pa shpërblim për përfundimin e shërbimit në përputhje me Ligjin e Punës të Shtetit të Katarit.

Neni 9

1. Kushtet dhe afatet e punësimit të punëtorëve nga Republika e Shqipërisë në Shtetin e Katarit përcaktohen me një kontratë pune individuale të lidhur ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit në përputhje me kontratën model bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

Kontrata përmban kushtet kryesore të punës në lidhje me të drejtat dhe detyrat që janë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Ligjit të Punës së Shtetit të Katarit.

2. Kontrata lëshohet në arabisht dhe anglisht në tri kopje origjinale, njëra prej të cilave duhet të mbahet nga punëdhënësi, e dyta nga punëtori dhe e treta duhet të depozitohet pranë Ministrisë së Punës të Shtetit dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit.

Neni 10

Kontrata individuale e punësimit përfshin detajet e detyrimeve të punëdhënësit në lidhje me strehimin e punëtorit dhe llojin e tij, ose pagesën e kompensimit të strehimit, si dhe trajtimin mjekësor.

Neni 11

Teksti në gjuhën arabe i kontratës së punës është teksti i njohur nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit dhe gjykatat në Shtetin e Katarit. Punëdhënësi nuk mund të bëjë ndryshime në dispozitat e kontratës së punësimit, përveçse kur ato janë më të favorshme për punonjësin dhe me miratimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit.

Neni 12

Kontratat e punësimit miratohen nga Ministria e Punës së Shtetit dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Doha, në rast se kontratat lidhen në Doha. Kontratat e lidhura në Republikën e Shqipërisë miratohen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë dhe Ambasada ose Konsullata e Shtetit të Katarit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

1. Autoriteti kompetent në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit monitoron zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

2. Në rast mosmarrëveshjes ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit që rrjedhin nga kontrata e punës, ankesa depozitohet në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale për t'u zgjidhur me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet zgjidhje me mirëkuptim, atëherë mosmarrëveshja i kalon për kompetencë autoriteteve gjyqësore kompetente në Shtetin e Katarit.

Neni 14

Kontrata e punës përfundon në datën e caktuar për mbarimin e saj pa një njoftim paraprak. Nëse punëdhënësi synon të vazhdojë kontraktimin, atëherë ai duhet të informojë punëtorin me shkrim për synimin e tij të paktën tridhjetë ditë përpara mbarimit të kontratës.

Neni 15

Punëtorit i lejohet të transferojë kursimet nga paga e tij, në përputhje me rregullat financiare që zbatohen në Shtetin e Katarit.

Neni 16

Të dyja palët krijojnë një komitet të përbashkët të përbërë nga jo më shumë se tre anëtarë nga secila palë, për të kryer funksionet e mëposhtme:

1. Koordinimin ndërmjet Qeverisë së Shtetit të Katarit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për të zbatuar këtë marrëveshje dhe marrjen e masave të nevojshme në këtë drejtim.

2. Interpretimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje në rastin e mosmarrëveshjeve që lidhen me të dhe zgjidhjen e çdo vështirësie që lind në zbatimin e saj.

3. Shqyrtimin e mundësive të punësimit që janë të disponueshme në Shtetin e Katarit, duke përfshirë informacione të përgjithshme mbi planet e zhvillimit në Shtetin e Katarit, mundësitë potenciale të punësimit në bazë të këtyre planeve, llojet dhe klasat e punës dhe aftësitë e kërkuara, si dhe vullnetin e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë për t'i shfrytëzuar ato.

4. Propozimin e rishikimit apo ndryshimit të të gjitha ose disa prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, nëse është e nevojshme.

Komiteti mbledhet në mënyrë të alternuar një herë në vit në të dy vendet, dhe kur është e nevojshme.

Neni 17

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Qeverisë së Shtetit të Katarit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe pas ndjekjes së procedurave të njëjta që kërkojnë për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 18

Kjo Marrëveshje do të ratifikohet nga të dyja Palët Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi nga data e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit. Ajo do të jetë në fuqi për tre vjet dhe do të jetë e rinovueshme për një periudhë të ngjashme, përveçse kur secila prej Palëve Kontraktuese kërkon ndërprerjen saj me anë të një njoftimi me shkrim gjashtë muaj para datës së përfundimit të saj.

Në dëshmi të kësaj, ne të nënshkruarit si më poshtë, të autorizuar sipas rregullit nga qeveritë përkatëse, nënshkruajmë këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Doha më _____ që korrespondon me 13.4.2014, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë ndryshimi, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

ANEKS

MODEL KONTRATE PUNËSIMI

Më _____ që korrespondon me _____ kjo kontratë është lidhur ndërmjet

1. Z./ si.....

Adresa e tij është _____

(Pala e parë)

2. Z. I pasaporta nr

Numri i dokumentit të identifikimit/kartës së familjes _____ me

Banim në adresën e mëposhtme

(Pala e dytë)

Kanë rënë dakord si më poshtë:

1. Pala e dytë punësohet nga Pala e parë si _____ në Shtetin e Katarit kundrejt një page mujore prej.....

2. Afati i kontratës:

A. Kjo kontratë është për një vit /dy vjet duke nisur nga data e fillimit të punës nga ana e palës së dytë në Shtetin e Katarit. Gjashtë muajt e parë janë periudhë prove, gjatë të cilës pala e parë mund të zgjidhë kontratën duke njoftuar palën e dytë një javë para përfundimit të gjashtë muajve dhe mbulon shpenzimet e kthimit të palës së dytë në atdhe. Nëse punonjësi realizon me sukses periudhën e provës, kontrata është e vlefshme për periudhën e mbetur. Kontrata do të përfundojë në datën e përfundimit të saj pa ndonjë njoftim paraprak.

Nëse pala e parë dëshiron të vazhdojë kontratën, ajo njofton palën e dytë me shkrim mbi dëshirën e saj për të rinovuar kontratën të paktën tridhjetë ditë përpara përfundimit të kontratës.

B. Kontrata mund të ndërpritet para përfundimit të kohëzgjatjes së saj, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës së Shtetit të Katarit. Përpara se pala e dytë të lërë punën, ajo shlyen të gjitha borxhet kundrejt palës së parë.

3. Shpenzimet e udhëtimit

A. Pala e parë mbulon shpenzimet e udhëtimit të palës së dytë nga tek vendi i punës në Shtetin e Katarit dhe shpenzimet e kthimit të saj. Ajo gjithashtu paguan biletën vajtje-ardhje të palës së dytë gjatë pushimeve të përcaktuara në kontratën e punësimit. Këto shpenzime nuk përfshijnë kostot e pasaportës apo pagimin e çfarëdo sigurimi.

B. Pala e parë nuk paguan shpenzimet e udhëtimit për t'u kthyer në shtëpi në dy raste:

1. Dorëheqje para përfundimit të kontratës, përveç rasteve të përfundimit të cilat parashikohen në nenin 51 të Ligjit të Punës së Shtetit të Katarit.

2. Bërjen e një gabimi që synon në shkarkimin e tij nga puna pa paralajmërim dhe pa i paguar atij shpërblimin e përfundimit të shërbimit në bazë të Ligjit të Punës së Katarit.

4. Huat

A. Pala e parë i paguan palës së dytë, nëse ajo dëshiron, një kredi personale prej....., në monedhën e Katarit, kur ai vjen në Shtetin e Katarit për herë të parë (rreth një muaj pagë) që do të zbritet nga detyrimet e palës së dytë në këste mujore prej 10% të pagës mujore bazë.

B. Zbritja e kësteve fillon nga paga e muajit që vjen pas fillimit të punës nga pala e dytë.

C. Huat e tjera që i paguhet palës së dytë në monedhën e Katarit rregullohen sipas dispozitave të përcaktuara në dy paragrafët e mësipërm.

5. Paga dhe shpërblimi

A. Punëtorët që paguhet me pagë mujore dhe me pagë ditore: Paga bazë është....., në muaj/ditë kundrejt 48 orë pune në javë.

Palës së dytë i jepet një pushim javor i paguar për një ditë çdo javë dhe paguhet në të holla në këmbim të punës jashtë orarit sipas dispozitave të Ligjit të Punës së Katarit.

B. Për punëtorët e prodhimit, punëtorët e përgjithshëm ose punëtorët me njësi: Paga bazë është në këmbim të punës mesatare ditore apo të tregtisë si vijon: Pagë shtesë paguhet për volumnin e punës së kryer nga ana e palës së dytë që është më i madh se mesatarja e punës së përditshme si më poshtë vijon:

..... Në rast se nuk ka punë prodhimi, paga e palës së dytë është.....

C. Pala e parë merr përsipër të shënojë numrin e orëve shtesë ditore të punës, sipas paragrafit (A) të kësaj pike, ose volumnin e punës të realizuar çdo ditë, sipas paragrafit (B) të kësaj pike, në një kartë të veçantë që i jepet në fund të ditës palës së parë për regjistrim.

D. Një shpërblim në fund të shërbimit prej.....

6. Strehimi dhe jetesa e përditshme

A. Pala e parë merr përsipër të sigurojë strehim të përshtatshëm falas prej beqari për palën e dytë dhe të njëjtin furnizim me energji elektrike, shtrëtër dhe tualete në përputhje me kushtet shëndetësore.

B. Pala e parë i siguron palës së dytë ujë të ftohtë të pijshëm.

7. Kujdesi mjekësor dhe asistencë sociale

A. Pala e parë i siguron palës së dytë trajtimin e nevojshëm mjekësor, në përputhje me rregullat dhe dispozitat që zbatohen në Shtetin e Katarit.

B. Pala e parë merr përsipër t'i paguajë palës së dytë kompensimin e duhur për aksidentet në punë, për paafësinë ose vdekjen që rezultojnë gjatë punës ose për shkak të saj, në përputhje me ligjet e Katarit.

8. Lejet

A. Pala e dytë ka të drejtën e një lejeje të rregullt vjetore të paguar prej jo më pak se tre javë, në bazë të nenit (72) të Ligjit të Punës së Katarit.

B. Pala e dytë ka të drejtën e pagës së plotë për festat zyrtare në vijim:

Bajram i Madh- Eid Alfitr: tri ditë pune.

Bajram i Vogël- Aid Aladha: tri ditë pune.

Dita Kombëtare: një ditë pune.

Dita Kombëtare e Sportit: një ditë pune.

Pala e dytë ka të drejtë gjithashtu për tri ditë leje të paguara që përcaktohen nga punëdhënësi.

C. Pala e dytë ka të drejtën e lejes së paguar në rast sëmundjeje pas kalimit të tre muajve punë të vazhdueshme pranë palës së parë, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës së Katarit.

9. Dispozita të përgjithshme

A. Pala e dytë merr përsipër të kryejë punën e saj në përputhje me normat e përditshme të performancës që janë tipike për punën e saj. Në rast moszbatimi të normave ditore të performancës, pala e dytë do të jetë subjekt i gjobave.

B. Pala e dytë nuk mund të punojë për të tjerët gjatë periudhës së punësimit, si dhe pala e parë nuk do ta detyrojë palën e dytë që të punojë për ndonjë punëdhënësi tjetër, përveç se në rastet e lejuara me ligjin e Katarit.

C. Pala e dytë merr përsipër të mos angazhohet në çështjet politike apo fetare. Ajo i kushton vëmendjen e duhur dhe respektin zakonet dhe traditat lokale.

D. Ligji i Punës i Katarit dhe vendimet në zbatim të tij përbëjnë bazën ligjore për dispozitat e kësaj kontrate dhe janë referencë për çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet dy palëve, përveç se kur kushtet e kësaj kontrate përmbajnë avantazhe më të mira për palën e dytë.

10. Kjo kontratë është hartuar në gjuhën angleze dhe arabe në tri kopje origjinale, njëra do të mbahet nga punëdhënësi, e dyta nga punëtori dhe e treta do të depozitohet pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit.

Pala e parë (punëdhënësi)

Pala e dytë (punëtori)

Miratur nga:

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, më _____

Dhe

Ambasada e Shtetit të Katarit në Republikën e Shqipërisë, më _____

Ose Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shtetit të Katarit, më _____

Dhe

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Katarit, më _____

VENDIM

Nr. 423, datë 25.6.2014

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË
BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E
SHËNDETËSISË, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
PËR BASHKËPUNIMIN E SHËNDETËSISË
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETIT TË KATARIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Katarit përfaqësuar nga Këshilli Suprem i Shëndetësisë, të quajtura më poshtë "Palët";

Në mbështetje të marrëdhënieve dypalëshe, miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, duke njohur rëndësinë e shëndetit publik dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm dhe duke besuar se shëndeti publik dhe shërbimet shëndetësore është një çështje rajonale që mund të lehtësohet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, dhe duke dëshiruar të bashkëpunojnë në fushën e shëndetësisë;

Kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Fushat e bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e shëndetësisë, e cila përfshin për nuk kufizohet tek sa më poshtë:

1. Bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë.
2. Organizimi i shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e kujdesit parësor shëndetësor.
3. Bashkëpunimi në fushën e laboratorëve të gjenetikës dhe mikrobiologjisë.

4. Koordinimi në shkallë sa më të gjerë, për të intensifikuar përpjekjet e tyre të përbashkëta me institucione ndërkombëtare shëndetësore, duke përfshirë Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe Këshillin e Bashkëpunimit për Shtetet Arabe (KBSHA).

5. Çdo formë e fushave të tjera të bashkëpunimit, e rënë dakord nga palët.

Neni 2

Qëllimet

Për arritjen e qëllimeve të këtij Memorandumi, palët do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme, si dhe në fusha të tjera të rëndësishme:

1. Studime dhe kërkime për aplikimin e një kujdesi shëndetësor efektiv, kërkime bio-mjekësore, vlerësimin dhe financim të kërkimeve bio-mjekësore, teknologjisë shëndetësore dhe shërbimeve shëndetësore, studime dhe vlerësime të ndikimit të ndërhyrjeve të rëndësishme të shëndetit publik në nivel popullate, studime të metodave alternative të zbatimit të kujdesit shëndetësor parësor.

2. Shkëmbimi i informacionit në lidhje me programet shëndetësore në të dyja vendet, si dhe shkëmbimi i artikujve dhe revistave shkencore dhe mjekësore.

3. Standardizimi i sistemeve të informacionit shëndetësor dhe epidemiologjisë, duke përfshirë komunikimin, metodat statistikore dhe shkëmbimin e informacionit.

4. Angazhimi ndaj cilësisë, specifikimeve dhe standardeve të kujdesit shëndetësor gjatë ofrimit të shërbimeve.

5. Sigurimi i financimit për kujdesin shëndetësor.

6. Kuadri ligjor për shëndetësinë.

7. Çdo fushë tjetër e rënë dakord nga palët.

Neni 3

Format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi që lind nga ky Memorandum mund të marrë format e mëposhtme:

1. Shkëmbimi i informacionit në fushën e shëndetësisë.

2. Shkëmbimi i shkencëtarëve, ekspertëve mjekësorë, infermierëve, nëpunësve mbështetës, drejtorëve të spitaleve dhe specialisteve të tjerë, si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në fushën e kujdesit shëndetësor.

3. Ofrimi dhe lehtësimi i mundësive për studime pasuniversitare dhe programe të trajnimit profesional në mjekësi për shtetasit e Katarit.

4. Sigurimi i pikave të drejtpërdrejta të kontaktit ndërmjet institucioneve dhe organizatave përkatëse.

5. Çdo formë tjetër bashkëpunimi e rënë dakord nga palët.

Neni 4

Financimi

Palët kanë rënë dakord se veprimtaritë e përmendura sipas këtij Memorandumi duhet të financohen me fondet e

alokuara sipas buxheteve përkatëse të disponueshme për çdo palë, sipas ligjeve vendore të zbatueshme në secilin vend. Secila palë mbulon shpenzimet e pjesëmarrjes së tyre, nëse nuk janë në dispozicion mjete alternative të përshtatshme për financimin e veprimtarive specifike, me shkrim nga autoritetet përkatëse në të dyja vendet.

Neni 5

Mbikëqyrja dhe monitorimi

Për ofrimin e mbikëqyrjes dhe bashkërendimit ndërmjet veprimtarive të përcaktuara në këtë memorandum dhe për të garantuar kushte optimale për realizimin e këtyre veprimtarive, palët duhet të krijojnë një komitet të përbashkët që përbëhet nga përfaqësues nga të dyja Palët. Komiteti zhvillon mbledhjen në mënyrë të alternuar në të dyja vendet.

Ministri i Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministri i Shëndetësisë në Shtetin e Katarit caktohen si përfaqësues për vendet e tyre dhe janë përgjegjës për zbatimin e kushteve të këtij memorandum, në vendet e tyre përkatëse.

Neni 6

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Palët promovojnë të drejtat e pronësisë intelektuale për çdo bashkëpunim në përputhje me këtë memorandum, ligjet vendore në fuqi dhe konventat ndërkombëtare në të dyja vendet.

2. Çdo publikim i informacionit ose i rezultateve të shkëmbimit të specialistëve, ekspertëve ose zyrtarëve qeveritarë ose seminareve, forumeve të përbashkëta për ekspertët ose projekteve të përbashkëta kërkimore, mund të përdoret nga secila palë pas miratimit të autoriteteve përkatëse të palës tjetër.

Neni 7

Ligji në fuqi

Kushtet e këtij memorandum zbatohen sipas ligjeve vendore në fuqi në të dyja vendet dhe pa cenuar këto kushte dhe detyrimet ndërkombëtare të secilës palë.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet palëve për shkak të interpretimit ose zbatimit të këtij Memorandum duhet të zgjidhet miqësisht nëpërmjet bisedimeve dhe konsulencës ndërmjet Palëve.

Neni 9

Amendimi

Ky memorandum ose ndonjë prej dispozitave të tij mund të ndryshohen me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të të dyja Palëve. Ky amendim hyn në fuqi datën e

shkëmbimit të dokumenteve të ratifikimit, në përputhje me procedurat e zbatueshme ligjore në vendet e Palëve përkatëse.

Neni 10

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi datën e shkëmbimit të dokumenteve të ratifikimit, në përputhje me procedurat e zbatueshme ligjore në të dyja vendet. Ky memorandum do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh dhe do të rinovohet automatikisht për periudhë(a) të ngjashme, nëse njëra palë nuk njofton tjetrën me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike, në lidhje me synimin e saj për t'i dhënë fund memorandumit të mirëkuptimit, me një njoftim 6 muaj përpara datës së mbarimit të tij.

Në dëshmi të kësaj përfaqësuesit e nënshkruar të autorizuar nga qeveritë e tyre kanë nënshkruar këtë memorandum.

Ky Memorandum nënshkruhet në qytetin e Dohas më Hijri që i korrespondon datës 13.4.20145, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr. 6, datë 10.6.2014

PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR ARSIMIN, FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE, SI EDHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 5, DATË 9.5.2014, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, "PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR NDARJEN E FONDIT PËR ARSIMIN, FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3 të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 5, datë 9.5.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpalljen e thirrjes për ndarjen e fondit për arsimin, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve", ndryshon, si më poshtë vijon:

a) "Shpalljen e thirrjes për projekte në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), në lidhje me shpërndarjen e fondeve në vlerën 945 000 000 (nëntëqind e dyzet e pesë milionë) lekë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014..."

2. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), në vlerën 945 000 000 (nëntëqind e dyzet e pesë milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit, brenda një jave nga publikimi i këtij vendimi, një kalendar me të gjitha afatet e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve (realizimit të investimit), për të vlerësuar realizimin e investimeve, përpara çeljes së fondeve për projektet e miratuara sipas pikës 2 të këtij vendimi.

4. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njësisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Arsimit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar
Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Mjedisit	anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

TABELA 1
PROJEKTET E ARSIMIT PËR FINANCIM NGA FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi	Vlera e plotë e projektit	Vlera e financimit 2014
QARKU BERAT					
1	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Kristaq Çapo" Bashkia Berat	09230	35,414,514	16,707,257
2	Komuna Roshnik	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare +kopsht, Karkanjoz, komuna Roshnik	9120	19,974,676	9,487,338
3	Bashkia Berat	Projekti "Shkolla, qendër komunitare" : Ndërtimi 3 fushave sportive polifunksionale në ambientet e shkollave, me lote (Shkolla "Ajet Xhindoli", lagjia Muzakaj prej 2,796,300L; Shkolla "28 Nëntori", prej 2,976,300L; shkolla "Xhemal Cekini" prej 3,653,076L)	9120	9,245,676	5,590,244
QARKU DIBËR					
4	Komuna Gjoricë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare dhe palestër Gjorice, Komuna Gjorice	09120	39,117,330	19,058,665
5	Komuna Lis	Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar "Abdyrrahman Përmeti", Komuna Lis (me prioritet)	09230	23,236,279	11,118,140
6	Komuna Xibër	Shkolla e bashkuar Xibër, Komuna Xibër	09120	55,673,855	26,836,928
7	Bashkia Peshkopi	Projekti "Shkolla, qendër komunitare" : Ndërtimi i 4 terreneve sportive në shkollat e qytetit Peshkopi (shkolla "Nazmi Rrushti; shkolla "Demir Gashi"; shkolla "Seit Najdeni"; shkolla "Selim Alliu")	09120	31,261,190	19,319,774
QARKU DURRËS					
8	Bashkia Durrës	Ndërtimi i murit rrethues i shkollës "Beqir Çela", Shkozë	09240	4,391,016	2,195,508
9	Bashkia Krujë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore në shkollën 9-vjeçare Nr.4, Krujë, Bashkia Krujë	09120	60,346,095	29,673,048
10	Komuna Nikel	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ramazan Karaj", Nikel, Komuna Nikel	09230	30,624,940	14,812,470
11	Bashkia Fushë-kruje	Ndërtim i shkollës së mesme "Shote Galica" Fushë-Kruje	09230	167,803,735	81,901,868
12	Bashkia Durrës	Projekti "Shkolla, qendër komunitare" : Rikualifikimi i hapësirave sportive të 4 shkollave të qytetit Durrës (shkolla "14 Nëntori" prej 8,274,040L; shkolla "Jusuf Puka" prej 6,908,148L; Shkolla "Marie Kaculini" prej 8,777,622L; shkolla e mesme profesionale "Jan Kukuzeli" prej 8,450,672L)	09120	32,410,482	21,066,813
QARKU ELBASAN					
13	Bashkia Belsh	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Halit Uruci" Belsh, Bashkia Belsh	09120	59,912,575	28,956,288
14	Komuna Stebleve	Ndërtim shkollë 1 katëshe, Shkolla Fushë-Studenti, Komuna Steblevë, Librazhd	09120	16,901,488	8,450,744
15	Bashkia Elbasan	Projekti "Shkolla, qendër komunitare" : Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në shkollat e qytetit Elbasan (shkolla "Naim Frashëri" prej 8,352,548L; shkolla "Sul Harri" prej 8,143,603L; shkolla "Abdyl Paralloi" 8,233,578L; shkolla "Adem Krasniqi" prej 9,772,643L)	09120	34,502,372	22,426,542

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi	Vlera e plotë e projektit	Vlera e financimit 2014
QARKU FIER					
16	Komuna Mbrostar	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Hiqmet Buzi", fshati Kallm, Komuna Mbrostar	09120	25,887,376	12,443,688
17	Bashkia Patos	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Zhani Gko", Patos	09230	43,424,308	20,712,154
18	Komuna Portez	Ndërtim kopshti, Komuna Portez	09120	11,100,000	5,550,000
19	Komuna Dushk	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Thanasaj, Komuna Dushk	09120	16,167,308	8,083,654
20	Komuna Dushk	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Riza Iberli" Zhame-Sektor, Komuna Dushk	09120	31,200,000	14,600,000
21	Bashkia Divjakë	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Miti Zaka", Bashkia Divjakë	09230	18,966,799	9,483,400
22	Komuna Fratar	Ndërtim kopshti i ri, Komuna Fratar	09120	8,770,781	4,385,391
23	Komuna Grabian	Ndërtim kopshti, Fshati 3 Urat, Komuna Grabian	09120	4,838,417	2,419,209
24	Bashkia Fier	Projekti "Shkolla, qëndër komunitare" : Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në shkolla të qytetit Fier, me lote (Shkolla "Jani Bakalli" prej 4,477,452L; Shkolla "Liri Gero" prej 5,323,962L; Shkolla "Kristaq Gero" prej 5,323,962L; Shkolla "Pinellopi Pirro" prej 5,323,962L)	09120	20,449,338	13,292,070
QARKU GJIROKASTËR					
25	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Siri Shaplllo", Bashkia Gjirokastrë	09230	38,327,134	18,163,567
26	Bashkia Gjirokastrë	Projekti "Shkolla, qëndër komunitare" : Terrene sportive në 4 shkolla (Shkolla "Pandeli Sotiri"; Shkolla "Thoma Papapano"; Shkolla "Cajupi"; Shkolla "Siri Shaplllo", lagje Granicë)	09120	28,050,728	18,232,973
QARKU KORÇE					
27	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Mësonjtorja e parë"	09120	58,116,016	28,058,008
28	Bashkia Maliq	Rikonstruksion nyje sanitare të shkollës së mesme Maliq	09230	2,183,000	1,091,500
29	Komuna Voskop	Rikonstruksion i shkollës së mesme Voskop sistem ngrohje , Komuna Voskop	09230	36,681,259	17,340,630
30	Bashkia Maliq	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Kolanec, Bashkia Maliq	09120	4,098,000	2,049,000
31	Bashkia Korçë	Projekti "Shkolla, qëndër komunitare" : Terrene sportive në 4 shkolla të qytetit Korçë (Shkolla "Demokracia"; Shkolla "Naum Veqilharxhi"; Shkolla "Sotir Gurra"; kompleksi shkollor Rruga "Ajet Xhindoli")	09120	37,100,000	24,115,000

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi	Vlera e plotë e projektit	Vlera e financimit 2014
QARKU KUKËS					
32	Komuna Arren	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare, Arren.	09120	24,190,485	12,095,243
33	Bashkia Kukës	Ndërtim i shtesës së shkollës 9-vjeçare "Bajram Curri", Kukës	09120	164,421,651	81,210,826
34	Bashkia Kukës	Projekti "Shkolla, qëndër komunitare" : Mjedise sportive në 4 shkolla 9-vjeçare (Ndërtim palestre sportive e shkollës "Lidhja e Prizrenit" prej 13,838,141L; Shkolla " Bajram Curri" prej 5,092,789L; Shkolla " Riza Spahiu" prej 7,074,444L; Shkolla " Ahmet Voka", Gostil, prej 4,868,624L)	09119	30,873,998	20,068,099
QARKU LEZHË					
35	Bashkia Lezhë	Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës, Bashkia Lezhë	09120	28,359,932	13,679,966
36	Bashkia Rubik	Sistemi i ngrohjes shkolla 9-vjeçare Rubik, Bashkia Rubik	09120	8,046,844	4,023,422
37	Komuna Kacinar	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Kaçinar, Mirditë	09120	16,000,000	8,000,000
38	Bashkia Lezhë	Ndërtimi i qendrës sportive tip, tek kompleksi i shkollave (2 qendra)	09120	20,518,380	13,336,947
QARKU SHKODËR					
39	Komuna Gruemirë	Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Gruemirë, Komuna Gruemirë	09230	22,882,694	10,601,502
40	Bashkia Vau i Dejës	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Aleksandër Paloci" Shelqet, Bashkia Vau i Dejës (shkollë e djegur)	09120	5,842,396	2,921,198
41	Komuna Bërdicë	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare "Berdice e Madhe", Komuna Berdica	09120	19,987,952	9,993,976
42	Bashkia Shkodër	Projekti "Shkolla, qëndër komunitare" : Mjedise sportive në 4 shkolla (Shkolla "Dëshmoret e Prishtinës" prej 2,442,622L; Shkolla "Ndoc Mazi" prej 8,751,168L; Shkolla "Ismail Qemali" prej 8.751.168L; Shkolla "Branko Kadia" prej 9,751,168L)	91120	29,696,126	19,302,482
QARKU TIRANË					
43	Bashkia Kavajë	Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.4 tek rruga "Sufajve" komuniteti i romeve Kavaje	09120	21,793,737	10,396,869
44	Komuna Vaqarr	Rikonstruksion , shtesë anësore 2 kate dhe palestër për shkollën e mesme të pergjithshme, Komuna Vaqarr	09230	32,351,875	15,175,938
45	Komuna Dajt	Shtesë kati i shkollës 9-vjeçare Qesarakë, Komuna Dajt	09120	47,653,498	22,826,749
46	Komuna Ndroq	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Sadi Nuri", Komuna Ndroq	09230	24,498,398	12,249,199
47	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme "Qemal Stafa", Njësia 10	09230	199,189,198	99,594,599
48	Bashkia Tiranë	Projekti "Shkolla, qëndër komunitare" : Terrene sportive në 4 shkolla 9-vjeçare të qytetit Tiranë (shkolla "7 Marsi" prej 6,800,987L; shkolla "Shkolla e Kuqe" prej 3,515,111L; shkolla "Servete Maci" prej 3,515,111L; shkolla "Skënder Luarasi" prej 3,515,111)	09229	17,346,320	11,275,108
QARKU VLORE					
49	Komuna Novoselë	Ndërtim shkolla 9-vjeçare "Pilo Prifti", fshati Novoselë, Komuna Novoselë	09120	48,661,651	23,330,826

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi	Vlera e plotë e projektit	Vlera e financimit 2014
50	Komuna Brataj	Shkolla e mesme e bashkuar "Hamdi Rrap Lazaj" Gjorm, Komuna Brataj	09230	19,990,045	9,995,023
51	Bashkia Vlorë	Rikonstrukcion kopshti nr.10, Vlorë, Bashkia Vlorë	09120	20,400,330	10,200,165
52	Bashkia Vlorë	Projekti "Shkolla, qendër komunitare" : Terrene sportive për 4 shkolla 9-vjeçare (Shkolla "Teli Ndini"; Shkolla "4 Heronjte"; Shkolla "Marigo Posio"; Shkolla Ibrahim Kushta"; Shkolla "Zigur Lelo"; Shkolla " Rilindja")	09120	24,358,850	17,100,000
TOTALI				1,773,328,472	945,000,000

Shënim:

"Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të)

"Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.

Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014, do të financohet nga FZHR për vitin 2015. ~

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006